

Shoqata Flag Pine

E themeluar në vitin 2013 dhe me seli qendrore në Orikum, Shqipëri, Shoqata Flag Pine është një organizatë jo-qeveritare me një përvojë të gjerë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin natyror dhe zonat e mbrojtura. Misioni kryesor i Flag Pine është promovimi i mbrojtjes së ekosistemeve tokësore dhe detare dhe ofrimi i zgjidhjeve për të zbutur apo eliminuar problemet mjedisore, duke krijuar ura bashkëpunimi midis komunitetit lokal dhe institucioneve qeveritare.

Zdravi Grad/Healthy City

E themeluar në vitin 2000 në Split, Kroaci, Healthy City është e përkushtuar ndaj përmirësimit të cilësisë së jetës përmes iniciativave parandaluese profesionale dhe shkencore, të fokusuara në shëndetin mjedisor, zakone të stilit të jetesës dhe marrëdhëniet ndërpersonale. Përveç programeve të saj bazë, Healthy City ofron një ekspertizë të fortë në komunikim, promovim, botim, trajnim dhe organizim të eventeve të nivelit të lartë.

 Shoqata Flag Pine


 ZDRAVI GRAD

 flagpine7@gmail.com

 ured@zdravigrad.hr

 zdravigrad.hr

TË DHËNA HAPËSINORE PËR VEPRIME PËR KLIMËN



REPUBLIC OF CROATIA
Ministry of Foreign
and European Affairs

Fokusi i projektit

Projekti synon të forcojë kapacitetet e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile përmes integritit të teknologjive hapësinore në programet e edukimit, me një fokus të veçantë në mbrojtjen e mjedisit dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike.



Kohëzgjatja: 15 Muaj

Partnerët: Shoqata Flag Pine, Healthy City

Buxheti: 85,000 Euro

Donatorë: Republika e Kroacië

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane

Objektivat

- Rritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile
- Përpilimi i rekomandimeve dhe strategjive për implementimin e rezultateve të projektit në politika që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të këtyre temave në Shqipëri
- Krijimi i një Plani Veprimi dhe manuali për integrimin e teknologjive hapësinore në kurrikulën mësimore të Shqipërisë
- Rritja e ndërgjegjësimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjes së mjedisit

Rëndësia e të dhënave hapësinore

Të dhënat hapësinore janë observime satelitore të Tokës të cilat grumbullojnë të dhëna për temperaturën, oqeanet, akujt, pyjet etj.. Këto të dhëna na mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- Monitorimin sistematik të nutrientëve në dete dhe nivelin e detit
- Monitorimin e shpyllëzimit dhe përdorimit të tokës
- Krijimin e një sistemi për detektimin e ngjarjeve ekstreme të motit



- Monitorimin e aktiviteteve të paligjshme
- Monitorimin e specieve invazive
- Monitorimin sistematik të zhvillimit të algave detare

